



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:015708

Datë: 10.05.2023

Numri i dokumentit: 04265944

PKR.nr.24/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, sipas Kryetarit të Trupit Gjykes Sami Sharaxhiu, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Tringa Zhuti, në lëndën penale ndaj të pandehurit B. (R.) H., nga f. B, K. I., për shkak të veprës penale *mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve* nga neni 366 par.1 të KPK-së, duke vendosur sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda PP/I.nr.3/23, të datës 04.02.2023 dhe Marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë me numër PP/I.nr.3/23, të datës 01.02.2023, në seancën publike të shqyrtimit për marrëveshjen e pranimit të fajësisë, të mbajtur me datë 03.05.2023, në praninë e prokurorit të shtetit Ersan Qavolli, të pandehurit B.H. dhe mbrojtësit të tij sipas detyrës zyrtares avokatit Bajram Lajqi, nga Peja, me datë 03.05.2023 murr dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 10.05.2023, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri

B.H., i lindur me datë, në f. B., K. I., me banim në “Rr. e K..” ... i biri i R. dhe S., e gjinisë S., i pa martuar, posedon numrin e telefonit .../... - ..., i gjendjes së mesme ekonomike, i njohur sipas numrit personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Në kohë të pacaktuar e gjer me datën 08.01.2023, rreth orës 01:10 min, në f. Z., K. K., mban në pronësi një revole me gaz në shkelje me Ligjin për Armët nenin 5 par. 1 dhe atë revole me ngjyrë të bardhë e modelit B.... C.. cal..mm me numër serik:-....., në atë mënyrë që pasi i pandehuri siguron armën e lartcekur, të njëjtën e posedon pa leje gjer me datën 08.01.2023 kur ndalohet nga policia, mirëpo i pandehuri armën e hedh nga panorama e veturës, të cilën zyrtarët policor e gjejnë dhe sekuestrojnë.

- me çka ka kryer veprë penale *mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve* nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform nenit 7, 8, 9, 10, 17, 21 par. 2, 39, 40, 43 par. 1, neni 366 par.1 dhe neni 366 par.3 të KPRK-së, nenit 358, 359, 360, 364, 449 të KPRK-së, të pandehurit i shqipton:

DENIM ME GJOBË

Ashtu që të pandehurit B.H. i përcaktohet dënimi me gjobë në shumë prej shtatëqind (700) €, të cilin dënim obligohet që ta paguaj ne afat prej tre (3) muaj, pas plotfuqishmërisë se aktgjykimit.

Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë të cekur si më lartë brenda afatit të caktuar, atëherë dënimi me gjobë do ti shndërrohet në dënim me burg në kohëzgjatje prej 20 ditësh ku një ditë burg do t'i llogaritet 20 euro.

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësor gjykatës t'ia paguaj shumën prej 50 €, dhe shumen prej 50 € në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

* * *

Ndaj të pandehurit **B.H.** në kuptim të nenit 366 par.3 të KPRK-së, shqiptohet

DËNIMI PLOTËSUES – MARRJA E SENDEVE/KONFISKIMI

- Një (.) pistoletë me g. e tipit B..... C..., ngjyrë e b. me d. K., cal..mm, me numër serik
- ... (.) karikator i pistoletës
- ... (.) copë fishek të kalibrit .mm

E të gjitha këto sende të evidentuara në Vërtetimin mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, me numër të rastit-D.-..., të datës 08.01.2023 të cilat urdhërohet që të shkatërrohen në afat prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda, ka ngrit Aktakuzën PP/I.nr.3/23, të datës 04.02.2023, ndaj të pandehurit B. (R.) H., nga f. B., K.I., për shkak të veprës penale *mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve* nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Me datë 01.02.2023 prokurori i shtetit ka hyrë në marrëveshjen për pranimin e fajësisë të lidhur në mes të Prokurorisë Themelore në Pejë të përfaqësuar nga prokurori Ersan Qavolli dhe i pandehuri B.H., në prezencën e mbrojtësit të tij avokatit Bajram Lajqi.

Gjykata mbajti seancën e shqyrtimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë me datë 03.05.2023, në praninë e prokurorit të shtetit, të pandehurit dhe mbrojtësit së tij.

Gjatë seancës u shqyrtua marrëveshja mbi pranimin e fajësisë ku sipas marrëveshjes, i pandehuri është pajtuar që për veprën penale *mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve* nga neni 366 par.1 të KPRK-së, t'i shqiptohet dënimi me gjobë në shumë prej 700 - 800

euro. Po ashtu i pandehuri është pajtuar që të heq dorë nga e drejta e tij për gjykim dhe gjithë të drejtat e tjera të përshkruara në deklaratën bashkëngjitur marrëveshjes, të cilën e konfirmuan edhe gjatë seancës.

Gjatë kësaj seance gjykata është bindur se i pandehuri i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare pas konsultimeve me mbrojtësin e tij dhe se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar apo i shtrënguar në asnjë mënyrë të pranoj fajin. Pranimi i fajësisë mbështetet në provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe se nuk ekziston asnjë rrethanë për hedhjen e aktakuzës që parashihet me nenin 357 par.1 dhe 2 të KPPRK-së.

Pas bindjes së gjykatës për të lartcekurat, dëgjimit të pikëpamjeve të prokurorit dhe të mbrojtësit të pandehurit lidhur me rastin e shqyrtimit të marrëveshjes së pranimit të fajësisë, gjykata konstatoj se i pandehuri e ka pranuar fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, i pandehuri është i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 242 par.2 të KPPRK-së janë përmbushur. Ashtu që gjykata aprovon marrëveshjen për pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 357 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 242 par.2 të KPPRK-së janë përmbushur, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas aprovimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, në kuptim të nenit 242 par.6 të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara në shkresat e lëndës e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit B.H. qëndrojnë elementet e veprës penale *mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve* nga neni 366 par.1 të KPRK-së

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i pandehuri e ka kryer veprën me dashje, ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të pandehurit, kështu që i njëjta është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin gjykata ka vlerësuar faktin se i pandehuri që në fazën fillestare e ka pranuar fajësinë, sjelljen e tij korrekte gjatë seancës së shqyrtimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë si dhe pendimin e thellë të tij, duke i premtuar gjykatës se në të ardhmen një gjë të tillë më nuk do ta përsërisë. Si rrethanë tjetër lehtësuese, gjykata mori për bazë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë të lidhur në mes të pandehurit dhe prokurorit të shtetit, ku i pandehuri ka pranuar fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë dhe kjo sipas vlerësimit të gjykatës paraqet pendim të sinqertë dhe fillim të procesit të rehabilitimit të tij. Ndërsa, rrethana rënduese gjykata nuk gjeti.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, gjykata në kuptim të nenit 69 të KPRK-së të pandehurin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me të cilin do të arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të pandehurit është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e

qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, por ai do të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 38 të KPPRK-së.

Duke u bazuar në nenin 449 të KPPRK-së, gjykata për të pandehurit i ka përcaktuar shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumë prej pesëdhjetë (50) euro dhe shumë prej pesëdhjetë (50) euro në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit

Ndaj të pandehurit në kuptim të nenit 366 par.3 të KPRK-së të KPRK-së, është shqiptuar edhe dënimi plotësues i marrjes së sendit, respektivisht konfiskimi i një (.) pistolete me gaz e tipit B..... C., ngjyrë e b... me dorëz k., cal.mm, me numër serik-....., ... (.) karikator i pistoletës, ... (.) copë fishek të kalibrit .mm dhe të njëjtat është urdhëruar që të konfiskohen.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 364 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr.24/23, më datë 10.05.2023**

Kryetari i Trupit Gjyqësor

Sami Sharaxhiu

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.